

GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS, Departamenti i Përgjithëshëm, si civile e shkallës së parë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtari Skender Shala – kryetar, gjyqtarëve porotë Hazir Metaj dhe Adnan Korogllu, anëtarë, procesmbajtëse Muradije Prékazi, në çështjen juridike të paditësit nga të cilin e përfaqëson avokat nga sipas autorizimit me shkrim, kundër të paditues nga Fsh. Komuna e te cilin e përfaqëson av. nga sipas autorizimit me shkrim, për besim të fëmiut të mitur, në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur më dt. 07.07.2015 muarr dhe shpallë këtë:

AKTGJYKIM

Fëmija i mitur lindur me 18.04.2013 nga martesë joformale e paditësit dhe të paditues mbetet në ruajtje, edukim dhe ushqimi të të paditues si nene.

Kontaktet e paditësit si baba, me fëmijën e mitur caktohen me saviyon:

- çdo të premte të parë dhe të trete të muajit vijues në ora 13 h deri në orën 16 h, kontaktet me fëmijën do të realizohen në Qendrën për Punë Sociale në e nën mbikqyrjen e organit të kujdestarise.

Ditën e dytë të festës së vitit të ri, ditën e dytë të festave fetare dhe ditën e ditëlindjes së fëmijës së mitur, fëmija do të jetë nën kujdesin e paditësit nga ora 11 h deri në ora 16 h.

Pranim - dorezimi i fëmijës do të bëhet në Qendrën për Punë Sociale në kurse per ditet kur Qendra për Punë Sociale në uk punon, pranim dorezimi i fëmijës do të bëhet në oborrin e QPS- në

OBLIGOHET paditsi qe në emer të ushqimise, edukimit dhe kujdesjes per fëmijën e mitur t'i paguaj te paditues kontributin financiar në shume prej 100.00 euro në muaj, duke bartur mjetet në konton e të paditues me se largu gjere me daten 5 te cdo muaji vijues.

E tera kjo duke filluar nga dita e formës së prerë të këtij aktgjykimi, e deri sa per kete te egzistojne kushtet ligjore, nën kercnim te permbarrimit te dhunshem.

OBLIGOHET paditsi qe në emer të shpenzimeve per kepuçet ortopedike per nevojat fëmijut t'i paguaj shumën e nevojshme per blerjen e kepuçeve ortopedike sipas sygjërimit mjekesor te specializuar dhe ate me se largu pese dite, nga dita e percaktuar në konstatimin ortopedik te specialistit, nga dita e formës së prerë te këtij aktgjykimi, e deri sa per kete te egzistojne nevojat e fëmijës, nën kercnim te permbarrimit te dhunshem.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta te procedures.

Ar sy e t i m

Paditësi ne padi dhe përmes të autorizuarit te tij ne seancat e shqyrtimit theksoi se me të paditurin ka qenë në bashkësi joformale martesore dhe gjatë kesaj bashkëjetese ka lindur fëmija i mitur i përbashkët i lindur me 18.04.2013. Ai theksoi se pas çrregullimit të raporteve në mes tyre dhe ndërprerjës së bashkjetesës fëmija i përbashket ka mbetur nën kujdesin e të paditures dhe se me ndërmjetësimin e organit të kujdestarisë kanë arritur një marrëveshje që ajo të ketë kontakte me fëmijën në lokale të Qendrës për Punë Sociale në por nuk janë realizuar sipas marrëveshjes. I deklaroi Gjykatës se është në mardhënje pune, ka të ardhura mujore dhe mundesi që të kujdeset për fëmijën. I kërkoi gjykatës që me aktgjykim të caktoi kohën dhe vendin e kontakteve të tij me fëmijën e përbashkët.

Ne fjalen e tij perfundimtare deklaroi se konsideroj se nga provat e nxjerrura ne shqyrtimin e sotem dhe procedure provuese ne menyre te pakontestueshme u vertetua bazueshmeria e kërkespadi së . Andaj, Gjykatës i propozojë që të njejtën ta aprovoj si të bazuar. Edhe më tutje mbeti pranë propozimit dhe mendimit se femija i mitur i ndergjyqësve pavarësisht moshës së tij duhet besuar paditesit si baba nga mendimi I QPS-se në dhe nga deklarata e dhënë si pale e paditesit konsiston fakti se femiu mund te rritet me babain e tij pasi qe edhe ne aspektin emocional eshte I lidhur me te dhe pershtaten ne mes veti. Kesaj duke shtuar edhe kushtet material, ekonomike dhe banesore te paditesit mendoj se kumulativisht permbushen kriteret dhe kushtet qe parasheh ligji qe njerit prind ti besohet ne edukim, rritje dhe kujdes. Gjithashtu duke u nisur nga sjelljet jokorrekte te te paditures per shkak se nuk ka respektuar premtimin e dhene gjykates qe paditesit t'ia mundesoi kontaktin me femiun e tij, ndersa paditesi deklaroi se ne rast se atij I besohet femiu, te paditures do t'ia mundesoi kontaktet e lira sipas dshires se saj, eshte edhe moment shtese qe gjykata te njejtit -paditesit te ia besoi femiun ne ruajtje dhe kujdes prindore.

Shpenzimet nuk i kerkoj.

E paditura në përgjigje të padisë dhe kerkespadi se dhe përmes të autorizuarit te saj ne seancat e shqyrtimit kryesor e kundërshtoi padine dhe kërkespadi së lidhur me kujdesin prindor ndaj fëmijës së përbashkët, nuk e kundërshtoj kontaktin e paditesit me femiun e tyre te perbashket ne QPS ne

Ne fjalen e tij perfundimtare i autorizuari i saj deklaroi se pas procedimit te kesaj ceshtje dhe te leximit te provave pa mëdyshje vertetohet fakti se kjo padi duhet te refuzohet nga gjykata si e pabaze, kur e them kete bazohet ne QPS ne dhe pjeserisht momente diskutabile te raportit te QPS ne ku ai raport potencon moshën e femiut nga kjo edhe ligjin mbi familjn e mbron interesin e femiut sic paraqet raporti I QPS ne. Gjykate e nderuar vete orari I punes prej ores 07,00-17,00 I paditesit e ben te pamundur perkujdesjen e tij, apo zavendesimin e perkujdesjes se nenes. Ne I propozojme gjykates nga keto rrethana dhe

gjithnjë duke u thirur në interesin e femiut që femiu të besohet nënës, kontaktet të caktohen me babain natyror nga gjykata në QPS në [] për çdo të dytën dhe të katërtën të premte të muajit nga 2 ore. Në emër të eliminacionit për perkujdesje të femiut dhe ushqimi kërkoj shumën prej 200 euro.

Në emër të shpenzimit për blerjen e kepuceve ortopedike në shumën sa do të kushtojnë ato kepuce në baze të mendimit të mjekut.

Shpenzimet e procedurës I kërkoj.

Kompetenca e kësaj gjykate për të vendosur në këtë çështje bazohet në dispozitën e nenit 11 pika 1. e Ligjit Nr. 03/L-199 për Gjykatat i publikuar në gazetën zyrtare të Kosovës Nr 79 datë 24 Gusht 2010 i zbatueshëm prej datës 01.01.2013, ku parashihet se "Gjykatat Themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse më ligj parashihet ndryshe".

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor, zhvilloi provat e propozuara dhe të nevojshme dhe pas administrimit dhe vlersimit të të njëjtave në kuptim të nenit 7 dhe 8 të LPK-es, erdhi në përfundim se duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi nga këto arsye.

Gjykata në procedurën e provave lexoi keto prova shkresore: certifikatën e lindjes E [] të dt. 18.12.2014, në emër të të miturit [] Urdhëri për mbrojtje C.nr.515/2014 të dt. 26.09.2014, Raporti socio – amnestik I QPS në [] nr. [] I dt. 27.05.2015, Raporti i QPS në [] i nr. [] I dt. 16.02.2015, mendimi I mjekut ortoped –traumatolog I dt. 20.03.2015 për nevojën që femiu ka për të bërë kepuce ortopedike, degjoi palet ndërgjyqse si pale dhe konstatoi këto gjendje faktike.

Nga Certifikata e lindjes E [] të dt. 18.12.2014, vërtetohet se femiu I mitur [] ka lindur me dt 18.04.2013, nga bashkjetesa e palve ndërgjyqse [] dhe []

Nga Urdhër për mbrojtje C.nr.515/2014 dat. 26.09.2014 vërtetohet se tani paditsit [] i është ndaluar që të shqetësoj, ushtroi dhunë psikike apo fizike, ndermarr çfarido veprimi me të cilin rrezikohet siguria, shëndeti dhe mirëqenia e pales së mbrojtur [] varesve dhe familjareve të saj. Femija i mitur [] perkohesisht mbetet në kujdesin e pales së mbrojtur tani të paditues [] si nënë, ndërsa kontaktet e pales përgjegjëse tani paditesit [] si baba ishte caktuar perkohesisht çdo të premte të parë dhe të tretë të muajit vijues nga ora 14,00-16,00 në QPS në [] Ndërsa në emër të kontributit financiar të perkohshëm për ushqimin e femiut të mitur [] pales së mbrojtur tani të paditues [] ti paguaj shumën mujore prej 100 euro. Afati i këtij urdher mbrojtje ishte caktuar për 6 muaj.

Nga raporti socio-amnestik të QPS-se në [] nr. [] dt.27.05.2015 ekipi profesional I QPS në [] pasi që analizoi rastin vendosi që të propozoi kësaj gjykate që femiu të mbetet nënës në ruajtje dhe perkujdesje, ndërsa babait të mundësohet kontakti I lirë me femiun.

Nga Raporti i QPS ne I vertetohet se perkitazi me besimin e femiut kane dhene mendimin se besimi I femiut si baba tani paditesit , nuk eshte ne kundersizim me interesat e femiut, por sipas tyre diskutabile mbetet mbrojtja me e mire e interesit te femiut duke pase parasysh moshen e femiut.

Nga mendimi I mjekut ortoped -traumatolog I dt. 20.03.2015 vertetohet fakti lidhur me nevojen qe femiu ka per te barte kepuce ortopedike dhe te cilat tani per tani duhet te nderrohen per cdo 6 muaj.

Paditsi ne cilësinë e palës ka deklaruar se ai ka kontaktuar me femiun tim me dt. 03.07.2015 ashtu sic eshte vendos nga gjykata. Ne kemi jetuar ne bashkesi jashte martesore-kena bashkejetuar 25 muaj per ate kohe na ka lindur djali I cili tani I ka 2 vjet e 2 muaj. Une mendoj se me mire eshte te me besohet femiu mua sepse une te njejtia ofroj kushtet me te mira te banimit, ekonomike si dhe mendoj se djali eshte I lidhur shume me mua, kete e kam vertetuar nga takimet e lira qe kam pasur ne muajin Prill, si dhe ne QPS ne . Sa I perket normalizimit te marrdhenive te mia me I tani per tani nuk mund te jap ndonje pergjigje perfundimtare per shkak te veprimeve te Sic e ceka me larte une punoj ne Reifajsen bank ne pagen mujore e kam neto 780 euro , prej tyre kam ndalesa rreth 390 Euro per kredi te cilen e kam marre per ndertermin e shtepise ne te cilen kam menduar te jetoj me familjen dhe me se bashku me djalin tone. Ne pyetje te te autorizuarit te paditesit se e e ka perlqimin e nenes se tij per me u kujdesur per femiun kur I njejtia eshte ne orarin e punes. I autorizuari I te paditures e kundersizton pyetjen e till nga arsyea se e njejtia e proidikon zgjidhjen e ceshtjes pa vendos ende gjykata. Ndersa pergjegjia e paditesit eshte po. I njejtia me tutje pergjigjet se femiu me mua ka tregua nje afersi edhe me te madhe se me pare sidomos tre rastet e fundit te takimit. I njejtia me tutje shton se femiu eshte normal dhe nuk ka ndonje nevoj te vecant dhe se e paditura nuk e ka ne gji. Me tutje I njejtia shton se ne rast se gjykata ma beson femiun mua, une nuk do te ia pengoj kontaktet me te. Ne pyetje te te autorizuarit te te paditures drejtuar paditesit I njejtia pergjigjet: orari im I punes eshte nga ora 08, deri ne 16,00 nga e hena deri ne te premten. Nga shtepia dale ne ora 07,00 dhe kthehem ne ora 17,00. Sa I perket afersise e ceka me larte. E pranon se din te pregatise ushqimin per femiun , ndersa pampersat une ia kam nderruar me shpesh. Femiu I jon bart kepuce ortopedike.

E paditura I ne cilesi te pales ka deklaruar se ne kemi jetuar ne bashkesi jashte martesore - kena bashkejetuar 25 muaj per ate kohe na ka lindur djali I cili tani I ka vetem 2 vjet e 2 muaj. Sa I perket pyetjes se te autorizuarit te paditesit se per cfar arsye eshte me mire te me besohet mua si nene sesa paditesit si babe , te drejten per ti u besuar nenes dhe se eshte nje e drejte sublime qe e perjeton vetem nana , eshte nje dashuri dhe afersi e pazevendesueshme qe femiut nuk mund ti ofroj kerkush, dashuri e pakusht, per qetesi, kujdesje, rahat, per mirreritjen e tij dhe eshte nje pergjegjesi shume e madhe te cilen e ushtroj pa kurrfar preteste me pergjegjesi dhe dashuri te plote, me tutje shtoi se eshte sjellur ne menyre normale gjithmon me femiun por ka pas raste kur me ka thene se po e lazderon shume femiun ,ndersa une I kam thene se duhet te sillemi ne raport me moshen e tij. e don djalin e tij. Do ta rrespektoj ne teresi

dhe e kam rrespektuar vendimin e gjykates perkitazi me kontaktin e me femiun. Sa I perket kontaktit te femiut me babain e tij, une do te veproj ashtu si do te merr gjykata vendim, per arsye se femiu eshte I moshes se till. Sa I perket shpenzimeve te mirerritjes dhe ushqimit te femiut mua me ndihmojne babai dhe vellau im te cilit jane te punesuar. Sa I perket thenjes se se une nuk e kam pasur fare femiun ne gji, kjo nuk eshte e vertet sepse une per pese muaj rreshte e kam ushqyre ne gji.

Ne pyetje te gjykates se a deshirojne palet ndergjygjse qe t'iu jepet nje afat ne menyre qe ti ipet shanse permiresimeve te raporteve ne mes tyre e gjithnje per hire te interesit te femiut, paditesi u pergjigj tani per tani jo, ndersa e paditura pergjigjet se une jam per me iu dhene nje mundesi te till.

Gjykata vendosi se eshte ne interesin e mireqenies dhe mirerritjes se femiut kujdesi i nenes nga arsyea se duke pas per baze moshen e femiut dhe lidhjen emotive te femiut me nenen ne kete faze te zhvillimit. Edhe nese kushtet ekonomike jane pak me te mira tek paditesi, pasi qe ai eshte ne mardhenje pune. Ndersa paditura nuk eshte ne mardhenje pune, per shkak te moshes shume te vogel te femiut, nga se tani i njejti ka vetem 2 vite e 2 muaj dhe nevojave e femiut per mirerritje, kujdes te nenes me shume te vleresuar ne krahasim me kushtet ekonomike. Prandaj gjykata konsideron se lidhja emotive e femmijes me nenen ne kete moshe prevalon kushtet ekonomike dhe eshte ne interesin e femijes qe te mbetet nen kujdesin e nenes.

Gjykata gjeti se kontaktet personale te paditsit me femijun e mitur jane ne interes te mirerritjes dhe mireqenjes se femijes dhe nga ana tjetër është e drejtë elementare e prindit jokujdestar që të ketë kontakte me femiun, e duke u nisur nga fakti se e paditura deklaroi se nuk do të pengoi në asnjë mënyrë kontaktet e femiut me paditesin si baba në mënyrën, kohën dhe vendin ashtu si do vendos gjykata me vendim, por ne ndertesen e QPS —se. Andaj, kontaktet duheshin lënë në kohë dhe vendin si në dispozitiv. Mbi këtë bazë u konstatua se kishte arsye për të vendosur si në nenin 140 pika 3 të Ligjit mbi familjen të Kosovës dhe të perkufizohen koha dhe vendi i kontakteve dhe u vendos mbi bazën e nenit 145 pika 1 dhe 2 e ligjit mbi Familjën ku parashihet se: *(1) Nëse femija jeton vetëm me njërin prind..., prindërit do të merren vesh për mënyrën e mbajtjes së kontakteve personale me femijët. Në rast të kontestit, vendimin lidhur me këtë gjë e merr gjykata kompetente.*

Organet i kujdestarisë ne i dhe kishin konstatuar se kontaktet duheshin caktuar dhe se kjo ishte në interes të femijës. Gjykata e aprovoi vetem pjeserisht kerkersen e te paditures qe kontaktet te caktohen vetem ne Qrendren per Pune Socile ne , kurse ditëve të jopunes dhe gjate festave kur QPS, nuk punon, gjykata aprovoj ate qe gjate diteve te festave te cekura si ne dispozitiv kontakti te zhvillohet me marrje te femiut ne shtepi nga ana e paditesit. Andaj, pretendimi i i të paditures për të lejuar kontaktet e prindit jokujdestar me femijën e mitur vetem ne Qendren per Pune Sociale ne , nuk u arsyetua me asnjërën nga bazat ligjore e si i tillë nuk u mbështet nga Gjykata.

Duke marre parasysh moshen e femiut dhe nevojat e pergjithshme te tij per ushqimin, zhvillimin dhe rritjen e drejte e duke vleresuar edhe obligimin e patjetersueshem ligjor te paditesit qe te kontriboi per ushqimin e femiut te vet, kjo gjykate e bindur paraprakisht se nuk rrezikohet ekzistenca materiale e paditesit, vendosi qe per kete qellim paditesi te kontriboi me shumen mujore prej 100 Euro ne muaj te specifikuar si ne dispozitiv, e qe kjo shum tani per tani eshte e mjaftueshme per nje jete normale dhe dinjitoze, per mireqenjen dhe mirrerritjen e femiut, duke konsideruar si te mundeshem rishikimin ne proceduren e metejme te permbarimit, varesisht nga rrethanat ekonomike te paleve ndergjyqse.

Gjykata pati ne konsiderate edhe dispoziten ligjore te parapare ne nenin 140 pika 4 e Ligjit mbi Familjen ku thuhet se: "Gjykata, me kerkesen e njërit prind ose të Organit të Kujdestarisë, do të ndryshojë vendimin mbi kujdestarinë, nëse këtë gjë e kërkojnë rrethanat e ndryshuara.

Mbi shpenzimet procedurale gjykata vendosi si në dispozitiv në kuptim të nenit 347 të Ligjit mbi Familjen të Kosovës.


Nga arsyet e paraqitura me larte, u vendos si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS

C.nr. 847/2014, dt . 07.07.2015.

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari

Skender Shala



KSHILLË JURIDIKE : Kunder ketij aktgjykimi eshte e lejuar anekesa, ne afat prej 15 (pesembedhjet) diteve, nga dita e pranimi, Gjykates se Apelit ne Prishtine, e permes kesaj gjykate.

Saktesine e pershkrimit e verteton: